V E N D I M
Nr.161, datë 30.10.2001

"NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i ""
Gjergj Sauli	Anëtar i ""
Alfred Karamuço	Anëtar i ""
Kujtim Puto	Anëtar i ""
Kristofor Peçi	Anëtar i ""
Petrit Plloçi	Anëtar i ""
Sokol Sadushi	Anëtar i ""
Tefta Zaka	Anëtare e ""

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 29.7.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.61 Akti që i përket:

KëRKUES:Faik Gugash Toska

subjekt i interesuar:GAFURR DUDA, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikutetues i vendimit nr.F-10, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.

Kërkuesit pretendojnë, në kërkesën e tyre, se vendimi i Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë që ka vendosur mospranimin e rekursit është antikushtetues për shkaqet e mëposhtme:

Megjithëse në rekurs janë ngritur shkaqe që parashikohen në nenet 472 shkronja "a" dhe 473 të Kodit të Procedurës Civile, kërkesë e domosdoshme për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë. që ka vendosur mospranimin e rekursit, i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.

Gjykata ka zbatuar keq nenet 12 dhe 16 të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve.

Gjykata ka zgjeruar shqyrtimin e çështjes tej objektit të padisë të kërkuar nga kërkuesi, gjë e cila vjen ndesh me kërkesat e Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata ka vendosur pranimin e kundërpadisë në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurës Civile, sepse objekti i padisë kishte të bënte vetëm me kërkimin e qerasë së truallit.

Vendimi i Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor në kuptim të nenit 41 pika 1 të Kushtetutës, duke shkelur të drejtën themelore për një proces të rregullt gjyqësor dhe të drejtën për ankim.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Tefta Zaka, kërkuesit, përfaqësuesin e subjektit të interesuar, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Kërkuesit kanë paraqitur rekurs në interes të ligjit pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë kundër vendimeve nr.9611, datë 4.12.1996 të Gjykatës së Rrethit të Tiranës nr.1542, datë 13.6.1997 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr.409, datë 17.12.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit.

Në rekurs, përveç pretendimeve të tjera, janë parashtruar disa shkaqe ligjore konform nenit 472 shkronja "a" të Kodit të Procedurës Civile, që kanë të bëjnë me zbatimin e keq të neneve 12 dhe 16 të ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronave, mosrespektim të ligjit lidhur me zgjerimin e shqyrtimit të çështjes tej objektit të kërkuar nga kërkuesi, pranimin e kundërpadisë në kundërshtim me

kërkesat e Kodit të Procedurës Civile, sepse objekti kishte të bënte vetëm me kërkimin e qerasë së truallit etj.

Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë në Dhomën e Këshillimit ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj, me argumentin se nuk përmban shkaqe nga ato që parashikohen në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile.

Bazuar më pretendimet e kërkuesve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtuese nga një proces i parregullt ligjor dhe në dokumentacionin e paraqitur, Gjykata Kushtetuese arrin në konkluzionin se kërkesa e tyre për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit nr. F-10, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues, duhet pranuar.

Kjo për faktin se shqyrtimi i rekursit në Dhomën e Këshillimit është i ndryshëm nga shqyrtimi i çështjes në seancë gjyqësore. Kompetencë e Dhomës së Këshillimit është vlerësimi i papajtueshmërisë së shkaqeve të ngritura në rekurs me kërkesat e neneve 472 e 473 të Kodit të Procedurës Civile.

Ndërsa përsa i përket bazueshmërisë në ligj të shkaqeve të parashikuara nga kërkuesi në rekursin e paraqitur prej tij, mund të gjykohet vetëm gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore.

Për sa sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimi se moskalimi i çështjes në seancë gjyqësore nga Kolegji Seleksionues i Gjykatës së Lartë i ka mohuar kërkuesve të drejtën për t'u mbrojtur dhe dëgjuar në seancë gjyqësore, duke mos u garantuar kështu zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131 e 132 të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e 77 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.F-10, datë 19.12.2000 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes Gjykatës së Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.